



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/23  
Datë: 12.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2026, merr këtë:

**V E N D I M**

- Emërohen anëtarët e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, si në vijim:
  - Rrezarta Korbaj, kryesuese;
  - Kimete Zekaj, anëtare;
  - Vlora Prenaj, anëtare;
  - Samir Lleshi, anëtar;
  - Fadil Sallteku, anëtar;
  - Kosovare Demi - Rama, anëtare;
  - Altin Sahiti, anëtar.
- Obligohen anëtarët, sipas paragrafit 1. të këtij Vendimi, t'i ushtrojnë detyrat dhe funksionet e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/23  
Datë: 12.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenin 13, paragrafi 1, të Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 122,000.00€ (njëqind e njëzetedy mijë eurosh), për financimin e projekteve kapitale "Renovimi i objektit të Qendrës së Panairit në Bërnice" dhe "Regjistri për Pronarët Përfitues".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga programi "Shpenzimet e paparashikuara", me kod 232, nga nënprogrami "Shpenzimet e paparashikuara", me kod 13100, nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale", nga projekti "Shpenzimet e paparashikueshme", me kod 13255, dhe transferohen në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, me kod 204, në kategorinë e shpenzimeve "Investime kapitale", si në vijim:
  - 2.1. Në nënprogramin "Regjistri Kosovar i Bizneseve", me kod 41400, shuma prej 60,000,00€ (gjashtëdhjetë mijë eurosh), për projektin "Regjistri për Pronarët Përfitues", me kod 19578;
  - 2.2. Në nënprogramin "Departamenti i Tregtisë", me kod 41100, shuma prej 62.000,00€ (gjashtëdhjetedy mijë eurosh), për projektin e ri "Renovimi i objektit të Qendrës së Panairit në Bërnice".
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/23  
Datë: 12.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 28 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Autorizohet pagesa në shumën prej 154,000€ (njëqind e pesëdhjetekatër mijë eurosh) për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për rritjen e kuotës së kapitalit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
2. Mjetet, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga bilanci bankar i Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe autorizohet Thesari i Kosovës që të procedojë me transferimin e kështit të dytë të mjeteve, në shumën përkatëse, në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatim të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë